



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.8 prot

Tepelenë, më 09 07.2026

PROCES-VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot më **09.07.2026**, në orën **11:00**, në Pallatit të Kulturës, Tepelenë (kati i dytë), ne mbledhjen jashte radhës së Këshillit Bashkiak Tepelenë.

Përfaqësues të Shoqërisë Rajonale e Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë Sh.A. Z.Gentian Lloga, Znj, Celestina Dajlani, znj. Marsela Osmanllari

Z. Jetnor Haska "Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Tepelenë"

Në momentin e hapjes së mbledhjes ishin të pranishëm këshilltarët: **Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Miftar Meta, Dino Selimi, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kaçaj.**

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z. Arben Gumeni**, pasi konstatoi praninë e kuorumit të nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes, deklaroi të hapur mbledhjen dhe paraqiti për shqyrtim rendin e ditës.

- **Informacion nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë sh.a.** mbi gjendjen e furnizimit me ujë të pijshëm në territorin e Bashkisë Tepelenë, tarifat e shërbimit, investimet e realizuara dhe të planifikuara, problematikat e evidentuara, si dhe masat e marra për përmirësimin e cilësisë dhe vazhdimësisë së shërbimit.

Kjo mbledhje është kërkuar nga anëtarët e Këshillit, sot këtu ka ardhur Drejtori i Shoqërisë Rajonale e Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë Sh.A për të marr informacionin që ju keni kërkuar, ju besoj i keni pyetjet gati.

Fjalën e mori Z. Gentian Lloga : Ju falenderoj për ftesën. Jemi këtu bashkë sot me Drejtorin e Ujësjellësit Tepelenë Z. Jetnor Haska dhe dy drejtorët të Shoqërisë Rajonale për të bërë një paraqitje të shkurtër të gjendjes së furnizimit të ujit të pijshëm në Bashkinë Tepelenë, si dhe të

japin një pasqyrë të investimeve të kryera, si edhe atyre në proces dhe në prespektivë. Kemi përgatitur një material në lidhje me çfarë na është kërkuar nga ana juaj të cilin do t'ua bëj prezent këshilltarëve.

Çelestina Dajlani : Përshëndetje të gjithëve! Në përgjigje të shkresës suaj po paraqes sot një relacion përmbledhes si më poshtë :

Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastrë Sh.A., nëpërmjet Njesisë Tepelenë, ushtron veprimtarinë e saj për furnizimin me ujë të pijshëm dhe shërbimin e kanalizimeve në territorin e Bashkisë Tepelenë, në zonat dhe sistemet që janë pjesë e administrimit të saj.

Njësia Tepelenë ushtron aktivitet në disa zona urbane dhe rurale, ku furnizimi realizohet nëpërmjet burimeve me vetërrjedhje, stacioneve të pompimit dhe rrjeteve ekzistuese të shpërndarjes. Sipas informacionit të administruar, furnizimi me ujë në Njësinë Tepelenë realizohet në 16 zona mbulimi, nga të cilat 9 zona furnizohen me stacione pompimi.

Situata e furnizimit me ujë në qytetin Tepelenë : Qyteti Tepelenë furnizohet kryesisht nga burimet Lekli dhe Bença. Aktualisht furnizimi me ujë paraqitet normal dhe realizohet me vetërrjedhje. Në periudhën korrik-tetor, kur prurjet e burimit të Leklit reduktohen, zona të caktuara të qytetit, si lagjja e Spitalit dhe zonat 6-7, furnizohen me ndihmën e stacionit të pompimit. Deri në momentin e raportimit, furnizimi vijon me vetërrjedhje dhe nuk janë evidentuar problematika madhore, përveç defekteve të zakonshme në rrjet, për të cilat është nderhyrë në kohë nga grupet e punës.

Në lidhje me vendosjen e matësave, nga të dhënat e administruara rezulton se në vitin 2022 Njësia Tepelenë kishte 2,931 kontrata ujësjiellësi, nga të cilat 1,956 konsumatorë ishin me matës, me nivel lidhjeje me matës rreth 67%.

Vendosja e matësave në kolonë të brendshme mbetet një proces i rëndësishëm për përmirësimin e administrimit të konsumit, uljen e humbjeve, shmangien e abuzimeve dhe rritjen e transparencës ndaj abonentëve.

Tarifat e ujit dhe faktorët që ndikojnë në përcaktimin e tyre : Tarifat e shërbimit janë përcaktuar në funksion të mbulimit të kostove operative, mirëmbajtjes së rrjetit, përmirësimit të shërbimit dhe nevojës për garantimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë.

Para vitit 2025, në Njësinë Tepelenë tarifa fikse mujore ishte 90 lekë për familjarët, 400 lekë për publiket dhe 250 lekë për privatët, ndërsa tarifa volumetrike e ujit ishte 33 lekë/m² për familjarët, 100 lekë/m² për publiket dhe 120 lekë/m² për privatet.

Në planin e ri tarifor për vitet 2025-2027, tarifa fikse për familjarët është përcaktuar 200 lekë/lidhje/muaj, ndërsa tarifa volumetrike e ujit për familjarët është 50 lekë/m². Për kategoritë

publike dhe private tarifa volumetrike e ujit mbetet përkatësisht 100 lekë/m² dhe 120 lekë/m². Ndryshimi i tarifave është i lidhur me nevojën për mbulimin e kostove direkte operative, pasi për vitin 2022 Njësia Tepelenë mbulonte vetëm 66% të kostos direkte operative nga të ardhurat e arkëtuara.

Për periudhën janar-maj 2026, të ardhurat e faturuara rezultojnë 10,754,405 lekë, ndërsa kostoja direkte për të njëjtën periudhë rezulton 14,501,013.90 lekë, me mbulim të kostos nga faturimi në masën 74%. Ndërkohë, arkëtimet totale për këtë periudhë janë 12,423,225 lekë, duke arritur mbulim të kostos me arkëtime në masën 86%.

3. Gjendja e furnizimit në zonat rurale dhe problematikat e evidentuara : Në zonat rurale të Bashkisë Tepelenë, furnizimi me ujë paraqitet i ndryshëm sipas burimeve, gjendjes së rrjetit dhe mënyrës së furnizimit. Disa zona furnizohen me vetërrjedhje, disa me pompim dhe disa me sisteme të kombinuara.

1-Fshati Matohasanaj furnizimi bëhet nga dy burime. Burimi i parë me rrjedhje të lirë dhe burimi tjetër me pompë. Burimi me rrjedhje të lirë arrinë ta furnizoj fshatin nga muaji Nëntor-Dhjetor deri në muajin Maj. Aktualisht furnizohet me pompë pasi burimi me rrjedhje të lirë ka shteruar furnizohen 3-4 orë në ditë, janë pa matsa nuk ka asnjë shqetësim nga banorët për furnizimin me ujë.

2-Fshati Dhëmbjan furnizohet me pompë është bërë ujësjells i ri, ndizet pompa 8 orë në ditë , janë 32 abonentë nga të cilët deri tani 14 me konsum pasi disa abonent furnizohen nga një burim tjetër. Janë me matsa nuk kanë patur problem deri më tani. Me furnizimin e tij furnizohen 3-4 orë në ditë. Si ujësjellëse ka patur një problem me galixhanin e depos të cilin në kemi ndërhyrë po përsëri ka shfaqur probleme.

3-Martalloz-Mehmetaj furnizimi me pompë ndizet pompa 8 orë në dy ditë, janë 17 abonent aktivë. Ky ujësjellës i është amortizuar rrjeti. Furnizimi bëhet afrofe .Ka patur probleme rrjeti kryesorë dhe disa ndërhyrje në rrjet. Me eliminimin e difekteve dhe të ndërhyrjeve disa herë kemi arritur ta normalizojmë furnizimin në këtë ujësjellës duhet ndërtur rrjeti i ri se është i amortizuar.

4-Fshati Salari furnizohet nga dy burime me vetërrjedhje dhe pompë. Burimi me vetërrjedhje Nëntor- Maj ku burim aktualisht ka shumë pak ujë. Tani fshati furnizohet vetëm me pompë furnizohet 2-3 orë ujë jenë me matsa po dhe depua në kaptazhe do mbi 10 orë të mbushet pasi burimi ka shumë pak prurje.

5-Fshati Dukaj furnizohet me pompë nuk kemi filluar kufizimin në orare aktualisht ka 12 orë ujë me rritjen e konsumit do fillojë ulja e orëve të furnizimit.

6-Fshati Veliqot furnizohet me pompë dhe vetërrjedhje aktualisht furnizohet 24 orë me rritjen e konsumit do të fillojë dhe ulja e orëve të furnizimit.

7-Fshati Beçisht furnizohet 24 orë në varësi të konsumit do fillojë dhe ulja e orëve të furnizimit.

8-Fshati Dragot furnizohet me pompë dhe vetërrjedhje në masën 70% me vetërrjedhje ku kanë ujë 24 orë dhe 30% me pompë ku kanë ujë 3-4 orë në ditë.

9-Fshati Kodër furnizohet me vetërrjedhje ka ujë 5 orë në ditë faturohet afrote për arsye të amortizimit të rrjetit nuk ka pasur probleme.

10-Fshati Lekël furnizimi me pompë ka ujë 6 orë në ditë nuk ka pasur probleme.

11-Fshati Luzat furnizimi me vetërrjedhje ,ka një rrjet teje të amortizuar si rrjeti i jashtëm dhe rrjeti i brendshëm. Që të kalojë me 24 orë ujë duhet ndërtuar ujësjells i ri për të cilin kemi bërë dhe kërkesa për investim.

12-Fshati Progonat furnizimi me vetërrjedhje 24 orë ujësjells i ri nuk ka pasur probleme të mëdha ka shfaqur problem vetëm në bashkimin e tubit me kasetën pasi nuk është përdorur bërryl po është lidhur direkt nga ana jonë është nderhyrë për riparim.

13-Fshati Nivicë Furnizim me vetërrjedhje 24 orë ujë nuk ka pasur probleme.

Sqarim mbi investimet e kërkuara nga Bashkia Tepelenë : Në lidhje me disa nga investimet e kryera nga Bashkia Tepelenë ato nuk janë marrë në dorëzim nga SHRUK GJ për shkak të mungesës së dokumentacionit i cili është kërkuar disa herë që nga momenti i krijimit të Shoqërisë Rajonale që janë :

Ujësjells i në fshatin Dhëmban

Ujësjells i ne fshatin Salari

Ujësjells i ne fshatin Nivicë

Ujësjells i ne fshatin Peshtan

Ujësjells i ne fshatin Progonat

"Matësat në kollonë në qytetin e Tepelenës"

Sqarojmë se keto investime janë të Bashkisë Tepelenë dhe nuk janë investime të realizuara nga Shoqëria Rajonale Ujësjells Kanalizime Gjirrokastër Sh.A. Pas përfundimit të punimeve nga Bashkia Tepelenë dhe pas dorëzimit të dokumentacionit të plotë teknik, akt-kolaudimit, inventarit të aseteve dhe procesverbalit të dorëzimit, shoqëria do të shqyrtoj mundësinë e marrjes në administrim të tyre, në përputhje me procedurat ligjore dhe teknike në fuqi.

Masat e ndërmarra dhe masat që propozohen : SHRUK Gjirrokastër Sh.A., nëpërmjet Njesisë Tepelenë, ka ndërmarrë masa për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues, eliminimin e defekteve, rritjen e kontrolleve në terren, përmirësimin e arketimeve, vendosjen e matësave dhe uljen e humbjeve në rrjet.

Për periudhën në vijim rekomandohet:

1. Vazhdimi i procesit të vendosjes së matësave për abonentët që nuk janë pajisur ende me matës.
2. Evidentimi i zonave me rrjet të amortizuar dhe hartimi i lists së nderhyrjeve prioritare.
3. Vijimi i kontrolleve në terren për lidhjet e paligjshme dhe debitorët.
4. Koordinimi me Bashkinë Tepelenë për investimet që janë në proces, me qëllim dorëzimin e tyre vetëm pas perfundimit dhe dokumentimit të plotë teknik.
5. Marrja në dorëzim nga SHRUK Gjirrokastër Sh.A. vetëm e atyre investimeve që plotsojnë kushtet teknike, janë të kolauduara dhe shoqërohen me dokumentacionin përkatës.

Në përfundim, furnizimi me ujë në qytetin Tepelenë paraqitet aktualisht i qëndrueshëm, ndërsa në disa zona rurale vijojnë të evidentohen problematika që lidhen kryesisht me amortizimin e rrjeteve, uljen e prurjeve gjatë sezonit të verës dhe nevojën për investime të reja.

SHRUK Gjirrokastër Sh.A. mbetet e gatshme për bashkëpunim institucional me Këshillin Bashkiak dhe Bashkinë Tepelenë, me qëllim përmirësimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe administrimin sa më të mirë të rrjetit, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore të secilit institucion.

Gentian Llogo : Në lidhje me investimet e reja dhe në lidhje me fshatin Gusmar AKUK ka bërë miratimin e këtij projekti. Jemi në procedurë për ndërtimin e këtij projekti dhe brenda një periudhe të shkurtër përfundon ky ujësjellës. Ndërsa, për sa i përket fshatit Luzat kemi dorëzuar projektin e përfunduar për të bërë opionencën të cilën e marr në shqyrtim AKUK. Ndërsa për ujësjellësat Sinanaj, Peshtan, Mamaj, Matohasanaj dosjet i ka AKUK i cili po i shqyrton. Për Hormoven, Turanin, jemi në kontakt me disa zyra projektësh. Për fshatin Bençe, Lekdush jemi në një moment diskutimi pasi këto dy fshatra furnizohen nga burimet, do shikohet mundësia për projekte për këto dy fshatra. Për sa i përket gjendjes së furnizimit me ujë, miratimi i tarifave varet nga enti rregullator i ujit dhe shoqëria jonë nuk vendos këto tarifa, ne bëjmë disa propozime në bazë të nevojave që kemi dhe vendosin ata për rritjen ose uljen e tarifave. Këto tarifa janë për vitin 2025-2026. Në janar të vitit 2027 rifillojnë procedurat për rishikimin e tarifës për të gjitha bashkitë dhe enti

rregullator vendos. Para disa ditësh na ka ardhur një shkresë nga Kryetari i Bashkisë në lidhje me disa problematika që janë evidentuar, që ne i kemi marrë në shqyrtim, të cilat do të jenë pjesë e pyetjeve dhe disa prej të cilave po shqyrtohen.

Arben Gumeni: Tarifa e ujit problematike e Bashkisë Tepelenë, sidomos për fshatra sepse në të gjithë qarkun tarifa e ujit me 270 lekë, kurse Bashkia Tepelenë dhe Bashkia Memaliaj e ka 500 lekë. Kjo tarifë kur u morë Vendimi i Këshillit Bashkiak u tha që të mos ketë rritje mbi 30%, ndërsa ju keni bërë rritje 50%, nga 330 lekë në 500 leke. Pse e kanë ndryshe çmimin fshatrat e Bashkisë Tepelenë? Nuk mund të diskriminohet në çmim. Tek riparimet këtu në qytet një pallat nuk është i lidhur me linjën e re. Pse materialet duhet të vijnë nga Gjirokastra për një riparim të vogël? Këtu nuk ka një magazinë për një defekt, sepse duke ardhur nga Gjirokastra rritet dhe kostoja, në Tepelenë ka dhe magazinë dhe administratë, pse mos të jetë këtu një magazinë për të zvogëluar shpenzimet? Për matsat ju thotë që u bë nga bashkia investimi. Këto investime do t'i merrni ju në dorëzim, por çfarë do merrni ju në dorëzim kur matsat nuk janë vendosur? Anëtarë bordi në Tepelenë dhe Memaliaj nuk kemi.

Rritje page është bërë për disa punonjës, të bëhet për të gjithë punonjësit.

Rritja e çmimit, të vendosen pompa inverte, sepse ulet kostoja

Gentian Llogo: Në kohën kur kemi vendosur së bashku me AKUK të bënim ndryshimin e tarifave njësitia Tepelenë dhe njësitia Memaliaj kanë pasur nivelin më të ulët të arkëtimit. Kjo është arsyeja që ne si shoqëri kemi bërë këtë propozim, por vendimi për ndryshimin e tarifave e ka enti rregullator. Në qoftë se në 2027 enti rregullator do marrë vendim për uljen e tarifës për një njësi të caktuar, ne do ta zbatojmë, propozimet tona behen vetëm për mbulimin e kostos.

Vladimir Bakiaj: Mbulimi i kostos me çfarë lidhet? Mbulimi i kostos lidhet me anën e performancës së ndërmarrjes apo vlerën e pagesës?

Gentian Llogo; Në bazë të arkëtimeve dhe shpenzimeve që ne mbulojmë, ne mbulojmë 7 njësi. për Tepelenë, mbulimi i kostove në vitin 2024 ka qenë i ulët. ERU-ja e ka afatin 2 vjet për ndryshimin e tarifës, në qoftë se gjykon që është i mjaftueshëm mbulimi i kostove atëherë nuk do të ndryshojë me, mund të marrë dhe vendim për uljen e këtyre tarifave. Niveli i mbulimeve të kostove në momentin që ne kemi hartuar dokumentat për tek enti rregullator kishte nivelin me të ulet dhe është vendimarrja e ERU-se për çmimin në fshatra.

Vladimir Bakiaj: Ju duhet të ndani abonentin nga mundësitë tuaja, abonentin nuk mbulon shpenzimet e ndërmarrjes.

Gentian Llogo: Une kam ardhur si drejtor rajonal për të dhënë përgjigje për Bashkinë Tepelenë, ju paguani për veten tuaj. Cmimi i ndryshueshëm në 3 fasha, në vitin 2027 në një fashë të vetme.

Vladimir Bakiaj: Ne ketu ju thirrem për tarifat.

Matilda Çela: Ne nuk morëm përgjigjet për tarifat. Kur është marrë vendimi, kush e ka miratuar këtë rritje? Ka pasur konsultim për çmimin e ujit? Kryetar, keni pasur ju njoftim për konsultim publik?

Gentjan Llogo: Ju keni bërë takimet tuaja. Ky takim ishte me publikun.

Dino Selimi: Pse tarifa e ujit nuk është e barabartë?

Gentjan Llogo: Në kohën kur kemi bërë propozimet tona ë ERU gjendja faktike e ujesjellësit Tepelenë kishte nivel të ulët të mbulimit të kostove dhe ne jemi të detyruar të bëjme propozime në lidhje me mbulimin e kostove, ky është qëllimi i shoqërisë tonë rajonale. Nuk kemi shkurtuar asnjë pozicion pune në Tepelenë, për shkak të terrenit dhe problematikave. Në këtë takim të vetëm une nuk mund të them ju problematikën që hasim çdo ditë në punën tonë. Shkurtimisht, për ceshtjen e tarifave ne pas 6 muajsh fillojmë procedurat për rishikimin e tarifave. Ju keni të drejtë të drejtoheni ERU-se për tarifat. Që nga muaji korrik kemi vënë në përdorim pompat e qytetit Tepelenë. Ka disa fshatra që kur jemi bashkuar kemi vendosur pompa të reja. Riparimet është çështje organizimi. Në fillim të vitit caktojmë një shumë e cila bazohet në bazë të kërkesave të çdo njësie. Gjatë kësaj kohe mund të dalin dhe problematika që ne nuk i kemi parashikuar. Nga investimet e qeverisë në vitet e fundit nevoja për materiale është ulur. Kemi probleme me KUZ në qytet kemi, edhe me rrjetin, ne reagojmë në kohe.

Dino Selimi: Tepelena dhe Memaliaj pse mos të kenë një magazine, kur ka një difekt në Tepelenë duhet që problemi të zgjidhet shpejt dhe në kohë.

Gentian Llogo: Materiale të përdorimit të përhershëm i kanë, në qoftë se ka pas raste dhe ne nuk kemi reaguar në kohë për furnizimin me ujë, vetëm kur digjet pompa. Kur janë djegur pompat në Salari dhe Dukaj, këto janë probleme, problem madhore është kur mund të lëmë një fshat pa ujë.

Vladimir Bakiaj: Për Tepelenën, investimet që janë bërë, jeni në dijeni apo jo? 40-50 abonentë nuk kanë sahat. Përse matësat vihen në kolektor? Kolektori është për shpërndarje dhe jo për matësa, matësi vendoset brenda objektit.

Gentian Llogo: Kolektori monitoron më mirë gjendjen. Në lidhje me investimet në ujesjellësit në fshatrat Dhëmban, Progonat, Salari, Nivicë, unë që nga 2023 e deri më sot i kam kërkuar Bashkisë Tepelenë informacion në lidhje me dosjet e këtyre investimeve, me qëllim për marrjen

përfundimtare të tyre. Për matësat në kolonë, në fshatrat Peshtan dhe Mezhegoran nuk i kam marr në dorëzim., kam kërkuar dokumentacion përkatës dhe nuk më është vënë në dispozicion. Nuk i kam marr në dorëzim si Shoqëri Rajonale.

Mirela Varfi: Lagjja Kordhaj ujësjellësi i ri, por 2 familje janë pa ujë.

Gentian Llogo: Po, e di që janë pa ujë. Ujësjellësin tuaj e kam bërë në kohë rekord, për ato 3 shtëpi po pres materialet dhe shumë shpejt do ta sjell ujin. Për anëtarin e bordit do flas drejtorja.

Marsela Osmanllari: Përfaqësuese e Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë: Bordi ka 7 anëtarë, 4 janë përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës, dhe 3 zgjidhen sipas numrit të aksioneve që kanë në shoqëri. Kemi përfaqësues të bashkisë Përmet, Gjirokastrë dhe Dropull, ndërsa për 3 bashkitë e tjera Libohovë, Kelcyrë dhe Tepelenë emërohet Sekretari i Këshillit dhe zgjidhet me rotacion çdo 12 muaj.

Gentian Llogo: Në lidhje me rritjen e pagave të punonjësve të ujësjellës Tepelenë u është rritur të gjithë paga, që nga janari në bazë të vendimit të qeverisë, dhe para 1 muaji kemi bërë një rishikim të pagave.

Matilda Cela: Sa % e punonjësve u është rritur paga?

Gentian Llogo: U është rritur të gjithëve, në fund të vitit në bazë të performancës do ketë rishikim page.

Dino Selimi: Ka shtesë rroge për punonjësit e KUZ-se?

Gentian Llogo : KUZ sektor i veshtirë, në fund të vitit do u rishikohet paga.

Matilda Cela: Pagat janë njëloj për të gjithë punonjësit e bashkive?

Genijan Llogo: Nuk kanë qënë njëloj, me ndryshimet e pagave që kemi filluar deri në fund të vitit të ardhshëm do të bëjmë një unifikim të pagave. KUZ-ja pak ndryshe, një përgjegjës i Tepelenës do ketë të njëjtën pagë si një punonjës i Gjirokastrës. Stacioni i pompimit jemi në fazën e projektit në rang rajoni.

Latif Kaçaj: Në zonën e Lopësit, problem me galixhan në fshatin Dhëmban.

Gentian Llogo: Në Dhëmban investim. Duhet të bëjnë kërkesë banoret për lidhjen e ujit. Depot janë me ujë në çdo moment, kostoja e energjisë në Dhëmban e lartë.

Vladimir Bakiaj: Investimet në Tepelenë do merren në dorëzim?

Gentian Llogo: Këto shqetësime do t'i përcjell në AKU në lidhje me të gjithë këto problematika, për investimet që ju pretendoni që nuk kanë përfunduar, dhe ata të dërgojnë grupet e punës për verifikimin dhe vazhdimin e procedurës.

Matilda Cela: Nuk ka ujë në fshatin Sinanaj. Do jetë në projekt? Në dijeninë time është bërë investim, keni informacion? Si furnizohet me ujë ky fshat?

Gentian Llogo : Në Sinanaj furnizohen nga dy burime. Nuk është bërë investim, është projekt.

Matilda Cela: Në mbledhjen e kaluar na erdhi material për marrjen në dorëzim të ujësjellësit Sinanaj.

Genijan Llogo : Është faza e parë Dhëmban - Sinanaj.

Matilda Cela: Arkëtimet 86% në qytet, monitorohen bizneset kush nuk paguan, familjet apo bizneset? Të merren masa. Familjarët e Bashkisë Tepelenë janë shumë të rregullt. Në qofte se biznesi nuk do që të paguaj, të merren masa deri në prerjen e ujit. Rritjen e çmimit në njësitë administrative e keni miratuar ju. Me këtë rritje që bëtë si i keni përdorur të ardhurat?

Gentian Llogo: Do të ketë një material kush paguan apo jo.

Marsela, Përfaqësuese e Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër: Pas riorganizimit të Shoqërive Ujësjellës, shoqëria rajonale mori të drejta dhe detyrime, dhe një borxh të trashëguar.

Gentian Llogo: Që nga janari i vitit 2023 Bashkia Tepelenë paguan detyrimet që i takon shoqërisë tonë, dhe shoqëria jonë e ujësjellësit u paguajnë shumën e taksave që mbledhin për llogari të bashkisë. Para 2023 nuk jam në dijeni për proceset gjyqësore. Kemi detyrimin tonë të paguajmë detyrimet tona dhe ata të na paguajnë detyrimet që na kanë. Ne jemi në proces të shlyerjes së detyrimeve që na takojnë, bashkia të shlyej detyrimet që ka.

Mbyllet mbledhja, ora 12:23.

SEKRETARE E KËSHILLIT
Valbona ÇELA

KRYETAR I KËSHILLIT
Arben GUMENI